



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:004399

Datë: 15.05.2024

Numri i dokumentit: 05686937

P.nr. 1/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË – DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Besnik Sheqiri, me procesmbajtëse Erblina Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurit A. A., për shkak të veprës penale “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës” nga neni 190 par. 2 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP/IL.nr.604/22F, të datës 30.12.2022, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit gjyqësor të mbyllur për publikun, të mbajtur me datë 19.04.2024 dhe paraqitjes së fjalës përfundimtare nga palët, në prezencë të prokurorit të shtetit Besart Mustafa, të dëmtuarës G. M., të pandehurit dhe mbrojtëses së tij av. A. Z., me datë 22.04.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 15.05.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

A. A., nga i ati R. dhe nëna E. e vajzërisë S., i lindur më ..., në M. të Gj. ku edhe tani jeton, ndërsa me adresë banimi në K. në fshatin O., Komuna P., me numër personal të identifikimit ... , ka të kryer shkollën e mesme, me profesion mjeshtrë uji, nxemje solare dhe klimë, tani i shkurorëzuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në kuptim të nenit 363 par. 1 nën par. 1.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPPRK)

LIROHET NGA AKUZA

Sepse:

Me datë 07.08.2022, rreth orës 13:36, në pikën kufitare në M. të Komunës së P., i pandehuri A. A., me qëllim që t’ia cenojë lirinë e lëvizjes të dëmtuarës – bashkëshortes së tij G. M. A., ia ka marrë në mënyrë të kundërligjshme dokumentacionin personal – Letërnjoftimin dhe pasaportën e Republikës së Kosovës, aufenthaltin – leje qëndrimin e Gj. në afat deri në vitin 2025, me qëllim që ajo mos të lëvizë lirshëm përkatësisht të mos kthehet në Gj., duke i cenuar kështu të drejtën elementare të garantuar me nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si e drejtë themelore e njeriut, edhe pse kjo dhe babai i saj i kanë kërkuar dokumentet nga i pandehuri A. për të cilën kërkesë është në dijeni edhe babai i të pandehurit R. A..

- me këtë i pandehuri kishte për të kryer veprën penale “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës” nga neni 190 par. 2 të KPRK-së.

I. Sepse gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është provuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

II. Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

III. E dëmtuara G. M., me vendbanim në fshatin G., Komuna P., nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.604/22F, të datës 30.12.2022, kundër të pandehurit A. A., për shkak të veprës penale “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës” nga neni 190 par. 2 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata në kuptim të nenit 280 të KPPRK-së ka caktuar kohën për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, ashtu që pas hapjes së seancës, shpalljes së çështjes për gjykim, konstatimit të prezencës së palëve, udhëzimit për të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, të pandehurit në kuptim të nenit 321 par. 1 të KPPRK-së, i ofroi mundësinë e deklarimit rreth fajësisë - të pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri në fillim të shqyrtimit gjyqësor është deklaruar i pafajshëm për veprën penale për të cilën është akuzuar, andaj në kuptim të nenit 323 të KPPRK-së shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me radhën e paraqitjes së provave, fjalën hyrëse të palëve, prezantimin e provave, mbrojtjen e të pandehurit, si dhe me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare të përgatitur me shkrim dhe të elaboruar shkurtimisht me gojë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 19.04.2024 ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës së parashtruar kundër të pandehurit A. A., në drejtim të veprës penale si në dispozitiv të aktakuzës, sepse është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, një gjendje e tillë faktike është vërtetuar bazuar në dëshminë e dëshmitares tani të dëmtuarës G. M., e cila në shqyrtim gjyqësor sikurse edhe në deklaratën e dhënë në polici, ka deklaruar se me të pandehurin ka qenë në bashkëshortësi për afërsisht gjashtë (6) muaj, raportet mes tyre kishin filluar të acaroheshin derisa ata kanë qenë duke bashkëjetuar në Gj., dhe se kur janë kthyer në K. me datë 07.08.2022 së bashku me të pandehurin dhe familjarët e tij babain, nënën dhe vëllain e tij, e dëmtuara kishte pasur me vete dokumentet personale si pasaportën dhe letërnjoftimin e K. dhe leje qëndrimin e shtetit të Gj., dokumente këto të cilat i pandehuri në pikën kufitare në M., pasi që zyrtarët policor i kanë kontrolluar, i pandehuri si drejtues i automjetit i ka pranuar ato dhe u ka dorëzuar të gjithëve përveç të dëmtuarës të cilës edhe përkundër kërkesës së saj që t’ia kthej, i njëjti nuk ia ka kthyer duke i thënë se do të ia kthejë më vonë. Përveç të dëmtuarës edhe babai i saj kishte kontaktuar me babain e të pandehurit R. A. nga i cili kishte kërkuar që vajzës së tij t’i kthehen dokumentet personale, ndërsa ky i fundit i kishte premtuar se do t’i kthejë dokumentet posa djali i tij të kthehej nga Sh., mirëpo edhe përkundër këtij premtimi asnjëherë dokumentet personale të

dëmtuarës nuk i janë kthyer, andaj pas administrimit dhe vlerësimit të provave dhe dëshmimeve në përgjithësi, rezulton se ekziston përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, gjykatës i propozoi që i njëjti të shpallet fajtor dhe dënohet sipas ligjit dhe me rastin e matjes së dënimit të ketë parasysh të gjitha rrethanat ligjore rënduese dhe lehtësuese, si rrethanë rënduese të merret fakti se vepra penale është kryer brenda marrëdhënies familjare.

E dëmtuara G. M. në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 19.04.2024 në fjalën e saj përfundimtare ka kundërshtuar pretendimet e të pandehurit se kinse prindi i tij R. A. nuk ka kontaktuar me babain e të dëmtuarës – dëshmitarin B. M., mirëpo sipas saj prindërit e tyre kishin kontaktuar dhe se në këtë bisedë telefonike babai i të pandehurit babait të saj i ka thënë se dokumente personale të saj i posedon djali i tij tani i pandehuri A. A. dhe se të njëjtat do t'ia dorëzojë sepse nuk i duhen mirëpo sipas së njëjtës asnjëherë deri më tani nuk i janë dorëzuar. E dëmtuara më tej shton se raportimi i rastit në polici nga ana e saj ka qenë me qëllim që i pandehuri të gjykohet dhe të marrë dënimin e merituar, ngase dokumentet që asaj i janë marrë pa të drejtë nga ana e tij janë personale dhe se askush nuk ka të drejtë që tjetrit t'ia marrë dokumentet personale dhe kufizojë lirinë e lëvizjes. Sa i përket kërkesës pasurore juridike, e njëjta është deklaruar se heqë dorë nga e drejta për të parashtruar një kërkesë të tillë.

Mbrojtësja e të pandehurit A. A. av. A. Z. në fjalën përfundimtare të përpiluar me shkrim dhe të elaboruar shkurtimisht me gojë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 19.04.2024 nga av. A. H. – I. me autorizim zëvendësues, ka deklaruar se me asnjë nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri A. A. ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe kjo për faktin se prokuroria nuk ka arritur që të vërtetojë veprimet inkriminuese të tij që do të përbënin elementet e figurës së veprës penale “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës” nga neni 190 par. 2 të KPRK-së. Në mbrojtjen e tij i pandehuri ka mohuar t'i ketë marrë dokumentet personale të dëmtuarës, në pikën kufitare në M. pas kontrollit të pasaportave nga personi zyrtar dhe pasi që i janë kthyer të pandehurit, ky i fundit të gjithë pasagjereve përfshirë këtu edhe bashkëshorten e tij tani të dëmtuarën G. M. ua kishte kthyer dokumentet personale përveç vëllait të tij F. A. - person me aftësi të kufizuara, andaj bazuar në këtë, mbrojtja konsideron se e vetmja provë të cilës prokuroria i është referuar me rastin e ngritjes së aktit akuzues është deklarata e të dëmtuarës e cila si e vetme nuk mund të merret si provë vendimtare me rastin e vendosjes lidhur me këtë çështje penale objekt i këtij shqyrtimi, kjo për faktin se kjo e fundit në deklaratën e dhënë në polici me datë 24.08.2022 kishte deklaruar se bashkëshorti i saj tani i pandehuri me datë 07.08.2022, në pikën kufitare në M. kishte ushtruar dhunë fizike ndaj saj dhe i kishte marrë dokumentet personale të udhëtimit e që bazuar në deklaratën e saj ishte përhapur lajmi në mediat sociale me titull “Burri rrah gruan në kufi të M.”, ndërsa më pas e njëjta në shqyrtim gjyqësor deklaroi se ditën kritike i pandehuri nuk kishte ushtruar dhunë fizike ndaj saj, po ashtu në deklaratën e dhënë në prokurori e dëmtuara kishte deklaruar se i kishte kërkuar dokumentet personale të saj nga i pandehuri, ndërsa në shqyrtim gjyqësor deklaroi se personalisht nuk i kishte kërkuar dokumentet personale nga i pandehuri mirëpo sipas saj prindi i saj kishte biseduar me prindin e të pandehurit lidhur me dokumentet andaj bazuar në të lartcekurat dhe në mungesë të vërtetuarit të faktit se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, gjykatës i propozoi që në kuptim të nenit 364 par. 1 nën-par. 1.3 të KPRK-së të njëjtin ta liroj nga akuza sepse nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

I pandehuri A. A. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohet me fjalën përfundimtare të mbrojtëses së tij, ndjehet plotësisht i pafajshëm, nga gjykata kërkoi që ta liroj nga akuza.

Gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike në këtë çështje penale juridike, në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 7 dhe nenit 361 të KPPRK-së, ka administruar provat e propozuara nga prokurori i shtetit si në aktakuzë, janë lexuar: Procesverbali i marrjes në pyetje në polici i të dëmtuarës G. M., me nr. të rastit ... i datës 24.08.2022, Procesverbali i marrjes në pyetje në prokurori i të dëmtuarës G. M. i evidentuar me nr. ... i datës 23.12.2022, Procesverbali i marrjes në pyetje në polici i të pandehurit A. A., me nr. të rastit ... i datës 26.08.2022, Procesverbali për Kontroll dhe Sekuestrim të përkohshëm, me nr. të rastit ... i datës 26.08.2022, Raporti i shpejtë, m nr. të rastit ... i datës 24.08.2022, Raporti fillestar i datës 24.08.2022, Shënimi zyrtar – Njësia e Hetimeve, Stacioni Policor në P., me nr. të rastit ... i datës 24.08.2022, Raporti i oficerit i datës 24.08.2022, ndërsa në cilësi të provës materiale është lexuar Raportimi nga gazeta10.com, i datës 25.08.2022, në cilësi të dëshmitarëve janë dëgjuar e dëmtuara G. M. dhe dëshmitari B. M., si dhe i pandehuri ka paraqitur mbrojtjen e tij.

E dëmtuara - dëshmitarja G. M., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 03.08.2023, e njoftuar më parë për të drejtën ligjore për të mos dëshmuar lidhur me çështjen për arsye se me të pandehurin kanë qenë në raport familjar respektivisht bashkëshort martesor, e drejtë kjo e paraparë me dispozitën ligjore të nenit 124 par. 1 nën-par. 1.1 të KPPRK-së, e njëjta ka hequr dorë nga ky privilegj dhe ka deklaruar se me të pandehurin A. A. ka qenë në lidhje bashkëshortore për afër gjashtë (6) muaj dhe për shkak problemeve që kishte pasur me të njëjtin në Gj., ishte kthyer në K. ku atë kohë kishte qëndruar afërsisht një muaj. Me datë 07.08.2022 ditën kur ngjarja ka ndodhur, ka ardhur nga Gj. së bashku me ish bashkëshortin e saj tani të pandehurin A. A., prindërit dhe vëllain e këtij të fundit dhe meqenëse i pandehuri ka qenë duke drejtuar automjetin, në pikën kufitare në M. të gjitha dokumentet personale përfshirë edhe ato të dëmtuarës i ka marrë për ti prezantuar tek zyrtari policor dhe pasi që ato i janë kthyer, prindërve dhe vëllait të tij u ka shpërndarë dokumentet e tyre personale përveç të dëmtuarës, edhe pse i kishte kërkuar menjëherë dokumentet e saj, i njëjti nuk ia kishte dhënë duke i thënë se do të t'i jap më vonë mirëpo edhe përkundër këtij fakti si dhe faktit se babai i saj i kishte kërkuar nga babai i të pandehurit që vajzës së tij t'i ktheheshin dokumentet personale dhe se ky i fundit sipas të dëmtuarës i është përgjigjur babait të saj se dokumentet do t'i sjell djali i tij posa të kthehet nga Sh., një gjë e tillë nuk kishte ndodhur, arsye kjo për të cilën e dëmtuara rastin e ka raportuar në polici.

Gjatë marrjes në pyetje në polici e dëmtuara ka deklaruar se me datë 07.08.2022, në pikën kufitare në M., pas kontrollit të dokumenteve personale nga personi zyrtar dhe pasi që i pandehuri i kishte pranuar ato, edhe përkundër kërkesës së saj që i pandehuri t'ia kthejë dokumentet e saj personale (pasaportën, letërnjoftimin e K. dhe vizën), i njëjti ka refuzuar duke i thënë se nuk do të t'i jap dokumentet, mirëpo e dëmtuara rastin nuk e kishte raportuar menjëherë në polici duke shpresuar se ky problem do të zgjidhej në mes familjeve të tyre. Gjatë qëndrimit në K., e dëmtuara mohon faktin të ketë ushtruar dhunë fizike apo psikike i pandehuri ndaj saj.

Gjatë marrjes në pyetje në prokurori për dallim nga dëshmia e dhënë në shqyrtim gjyqësor, e dëmtuara ka deklaruar se me datë 07.08.2022, në pikën kufitare në M., pasi që i pandehuri kishte pranuar dokumentet personale nga personi zyrtar, përveç të dëmtuarës nuk ua kishte kthyer dokumentet e tyre personale as bashkudhëtareve tjerë, ndërsa disa ditë më vonë, bazuar në deklaratën e saj, i pandehuri pretendon t'i ketë thënë se i posedon dokumentet personale të saj mirëpo asnjëherë nuk do të ia kthejë. Në mbrëmjen e ditës së njëjtë, e dëmtuara së bashku me ish bashkëshortin e saj tani të pandehurin dhe familjarët e tij, fillimisht kishte shkuar në fshatin O. në shtëpinë e të pandehurit dhe nga aty ky i fundit të dëmtuarën e kishte dërguar në fshatin G. tek familja e saj, ndërsa një ditë më vonë e dëmtuara e kishte kontaktuar të

pandehurin dhe i kishte thënë se nuk mund të vazhdojë jetën me të për arsye të dhunës psikike dhe fizike që i njëjti në vazhdimësi kishte ushtruar ndaj saj dhe se dëshiron të ndahet nga ai. Menjëherë pas bisedës mes tyre, sipas të dëmtuarës, i pandehuri kishte shkuar tek shtëpia e saj dhe e kishte thirr për të biseduar me të jashtë shtëpisë dhe kur të njëjti i kishte përsëritur fjalët se nuk dëshiron të vazhdojë me të, i pandehuri e kishte kapur për flokësh dhe kishte tentuar që pa dëshirën e saj ta fus në veturën e tij, mirëpo meqenëse me të dëmtuarën kishte qenë edhe mbesa e saj 3 vjet e gjysmë e cila kishte filluar të qaj, i pandehuri ishte larguar.

Dëshmitari B. M., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 07.08.2023, i njoftuar më parë për të drejtën ligjore për të mos dëshmuar lidhur me çështjen për arsye se me të pandehurin ka qenë në raport familjar gjegjësisht vjehërr/dhëndër, e drejtë kjo e paraparë me dispozitën ligjore të nenit 124 par. 1 nën-par. 1.2 të KPPRK-së, i njëjti ka hequr dorë nga ky privilegj dhe ka deklaruar se lidhur dokumentacionin e vajzës së tij se i pandehuri A. A. ia kishte marrë kësaj të fundit kishte kuptuar 2-3 ditë pasi që ata kanë ardhur nga Gj., ndërsa me datë 23.08.2022, në ora 11:26 min ka kontaktuar përmes telefonit me R. A. prindin e të pandehurit, që ta njoftojë atë që të ftohen njerëzit nga dy familjet për t'i dhënë fund lidhjes në mes vajzës dhe dhëndrit të tij, po ashtu nga i njëjti kishte kërkuar që vajzës së tij t'i kthehen dokumentet (letërnjoftimi, pasaporta e Republikës së K. dhe dokumentet e Gj.), ndërsa sipas këtij dëshmitari, R. A. i është përgjigjur se djali i tij është duke ngrënë bukë dhe se dokumentacionin e vajzës do e kthejnë ngase nuk u duhen asgjë. Edhe pse së bashku me bashkëshorten dhe vajzën e tij tani të dëmtuarën me datë 18.08.2022 kanë qenë në shtëpinë e të pandehurit, dokumentacionin e vajzës së tij nuk e kishte kërkuar nga i pandehuri e as nga babai i këtij të fundit, për arsye se sipas tij situata në mes tyre ka qenë e tensionuar për shkak të vrazhdësisë dhe sjelljeve të pandehurit.

Gjykata në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 07.08.2023 ka aprovuar propozimin e prokurorit të shtetit dhe të dëmtuarës G. M. që në cilësi të dëshmitarit të ftohet dhe të dëgjohet R. A. prindi i të pandehurit, mirëpo në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 15.04.2024, edhe pse i njëjti ka prezantuar në seancë, i njoftuar më parë për të drejtën ligjore për të mos dëshmuar lidhur me çështjen për arsye se me të pandehurin është në raport familjar gjegjësisht babai i të pandehurit, e drejtë kjo e paraparë me dispozitën ligjore të nenit 124 par. 1 nën-par. 1.2 të KPPRK-së, i njëjti ka shfrytëzuar këtë privilegj dhe ka deklaruar se nuk dëshiron që të dëshmojë.

Pas marrjes në pyetje të dëmtuarës - dëshmitares G. M., dëshmitarit B. M., si dhe prezantimit të provave materiale, në kuptim të nenit 343 par. 1 të KPPRK-së, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me marrjen në pyetje të pandehurit i cili në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 15.04.2024 sikurse edhe gjatë marrjes në pyetje në polici, në mbrojtjen e tij ka mohuar të ketë kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, duke u mbrojtur me faktin se në kohën e përshkruar si në aktakuzë, së bashku me bashkëshorten e tij G. M., prindërit dhe vëllain e tij, nga Gj. në K. kishin ardhur përmes pikës kufitare në M. dhe meqenëse ka qenë duke drejtuar automjetin e tij, dokumentacionin personal të tij, bashkëshortes, prindërve dhe vëllait të tij ia ka dorëzuar për kontroll personit zyrtar dhe posa i ka pranuar ato, ua ka shpërndarë të gjithëve (nënës, babait dhe bashkëshortes së tij G. M.), përveç vëllait të tij F. A. i cili është me invaliditet në shkallë 100%. Po ashtu në mbrojtjen e tij i pandehuri kundërshtoi pretendimet e prokurorisë se të dëmtuarës bashkëshortes së tij G. M., me qëllim të cenimit të lirisë së lëvizjes ia ka marrë në mënyrë të kundërligjshme dokumentacionin personal dhe atë letërnjoftimin, pasaportën e Republikës së Kosovës dhe aufenthaltin-leje qëndrimin e Gj. me afat deri në vitin 2025 me qëllim që mos të lëvizë lirshëm dhe mos të kthehet në Gj. ngase sipas tij e dëmtuara e as ndonjëri nga anëtarët e familjes së saj asnjëherë nuk i kishin kërkuar atij dokumentet personale të saj dhe

nuk kanë pasur një arsye të tillë përderisa e njëjta i ka pasur në posedim, përveç këtij fakti, edhe pse me datë 11.08.2022 së bashku me bashkëshorten e tij G. M. kanë marrë pjesë në dasmën e motrës së tij e po ashtu edhe me datë 18.08.2022 G. së bashku me prindërit e saj kanë qenë në shtëpinë e tij në fshatin O., për asnjë moment nuk ka qenë temë diskutimi çështja e dokumenteve edhe pse ky edhe kishte qenë kontakti i fundit në mes familjeve të tyre, ndërsa me datë 22.02.2023 janë shkurorëzuar.

Rrjedhimisht gjykata, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave dhe vlerësimit me ndërgjegje të secilës provë një nga një dhe në lidhje reciproke me njëra tjetrën, konform nenit 360 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, vërteton se nuk është provuar fakti konkret se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Nuk ishte kontestues fakti nga i pandehuri se me datë 07.08.2022, në pikën kufitare në M., dokumentet personal të tij, bashkëshortes, prindërve dhe vëllait të tij ia kishte dorëzuar për kontroll personit zyrtar dhe posa i ka pranuar ato, ua kishte shpërndarë të gjithëve përveç dokumentacionit të tij dhe të vëllait të tij F. A.. Po ashtu nuk ishte kontestuese se me datë 11.08.2022, së bashku me ish bashkëshorten e tij G. M., kanë prezantuar në dasmën e motrës së tij, sikurse nuk ishte kontestuese se me datë 18.08.2022 ish bashkëshortja dhe prindërit e saj për herë të fundit kishin qenë në shtëpinë e tij në fshatin O. të P..

Kontestues nga i pandehuri ishte fakti se ish bashkëshortja e tij tani e dëmtuara G. M. asnjëherë nuk i kishte kërkuar atij dokumentet personale të saj për të cilat prokuroria në aktakuzë pretendon se të njëjtës i janë marrë në mënyrë të kundërligjshme, duke u mbrojtur me faktin se sipas tij kjo ishte një ngjarje e sajuar nga ana e saj me qëllim që t'i krijojë probleme atij siç edhe i kishte premtuar se do e fus në burg për çka edhe do e humbë vendin e punës.

Nga Procesverbali për Kontroll dhe Sekuestrim të Përkohshëm, me nr. të rastit ... , i datës 26.08.2022, rezulton fakti se Policia e Kosovës – Stacioni Policor në P., në prezencë të avokatit mbrojtës të pandehurit A. A., në fshatin O. të P., ka zbatuar urdhëresën për kontroll në shtëpinë e të pandehurit, nën dyshimin e bazuar se në shtëpinë e tij gjendet dokumentacioni personal i të dëmtuarës G. M., mirëpo pas përfundimit të kontrolli të shtëpisë dokumentacioni në fjalë nuk është gjetur.

Provat e propozuara nga prokurori i shtetit për tu administruar në shqyrtim gjyqësor dhe atë: Raporti i shpejtë me nr. të rastit ..., i datës 24.08.2022, Raporti fillestar, i datës 24.08.2022, Shënimi zyrtar – Njësia e Hetimeve, Stacioni Policor në P., me nr. të rastit ..., i datës 24.08.2022 dhe Raporti i oficerit, i datës 24.08.2022, gjykata nuk i shqyrtoi më tej për arsye se nuk e kanë statusin e provës në procedurë penale pa marrë parasysh përmbajtjen e tyre, ngase këto raporte kanë karakter operativ të komunikimit mes autoriteteve policore¹, mirëpo edhe pse janë administruar si prova në shqyrtim gjyqësor, të njëjtat nuk paraqesin relevancë apo nuk vërtetojnë asnjë fakt konkret në këtë çështje penale.

Sipas lajmit të publikuar nga portali gazeta10.com, të datës 25.08.2022, në ora 09:22, me titull “Mërgimtari rrah gruan dhe ia merr dokumentet menjëherë pasi hyjnë në K.”, nga përmbajtja e të cilit rezulton se me datë 24.08.2022, viktima femër kosovare ka raportuar se pas disa mosmarrëveshjeve që kishte pasur me bashkëshortin e saj të dyshuarin mashkull kosovar, derisa ishin në Gj., pasi kanë hyrë në K., i njëjti duke ushtruar dhunë fizike i ka marr dokumentet personale të viktimës...”, provë kjo e cila edhe pse është aprovuar nga gjykata që

¹ Aktgjykimi kolegjit penal i Gjykatës Supreme të Kosovës, PML.nr.199/2023, i datës 19 maj 2023

të administrohet si provë në shqyrtim gjyqësor, nuk provon faktin konkret se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Nga deklaratat e të dëmtuarës – dëshmitares G. M. është vërtetuar fakti se me datë 07.08.2022, në pikën kufitare në M., ish bashkëshortit të saj tani të pandehurit A. A., i kishte dhënë dokumentet e saj personale dhe atë letërnjoftimin, pasaportën e Republikës së Kosovës dhe aufenthaltin - leje qëndrimin e Gj. me qëllim për ti dorëzuar personit zyrtar për kontrollin e dokumenteve, mirëpo faktin se i pandehuri nuk ia kishte kthyer dokumentet personale pasi që ajo i kishte kërkuar, përveç deklaratave kundërthënëse të saj, nuk e ka bërë të besueshëm me asnjë provë konkrete, relevante dhe të besueshme për të bindur gjykatën se i pandehuri me të vërtetë ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Jo konsistenca në deklaratimet e saj qëndron në atë se gjatë marrjes në pyetje në polici e dëmtuara ka deklaruar se edhe pse menjëherë pas kontrollit të dokumenteve nga personi zyrtar i kishte kërkuar ato nga i pandehuri, ky i fundit kishte refuzuar duke i thënë se **“nuk do të t'i jap”**, mirëpo ka mohuar që gjatë qëndrimit në K. i pandehuri të ketë ushtruar dhunë fizike apo psikike ndaj saj, ndërsa në deklaratën e dhënë në prokurori ka deklaruar se pas kontrollit të dokumenteve nga personi zyrtar, përveç të dëmtuarës të cilës nuk ia kishte dhënë dokumentet e saj personale, i pandehuri nuk ua kishte kthyer dokumentet personale as bashkudhëtareve tjerë, përveç kësaj, një ditë më vonë respektivisht me datë 08.08.2022, i pandehuri kishte shkuar në shtëpinë e saj në fshatin G. dhe kur të njëjtit i kishte thënë se nuk dëshiron të jetoj më me të, i pandehuri e ka kapur për flokësh dhe ka tentuar që pa dëshirën e saj ta fus në veturën e tij. Në shqyrtim gjyqësor e dëmtuara përsëri ndryshon deklaratat e saj duke deklaruar se i pandehuri “ka shpërndarë dhe dorëzuar dokumentet personale prindërve dhe vëllait të tij përveç dokumenteve personale të saj dhe kur e njëjta menjëherë i kishte kërkuar ato nga i pandehuri, i njëjti i është përgjigjur duke i thënë se **“do të t'i jap më vonë”**.

Gjykata po ashtu ka analizuar edhe deklaratën e dëshmitarit B. M. dhënë në shqyrtim gjyqësor nga e cila rezulton fakti se lidhur me dokumentet personale të vajzës së tij tani të dëmtuarës G. M. kishte kuptuar 2-3 ditë pasi këta të fundit kishin ardhur nga Gj. në K., e që sipas tij këto dokumente (letërnjoftimi, pasaporta e Republikës së Kosovës dhe dokumentet e Gj.) i kishte kërkuar përmes telefonit nga babai i të pandehurit tani dëshmitarit R. A., bisedë kjo sipas tij e realizuar me datë 23.08.2022, deklaratën e të cilit gjykata e çmoi si të pabazuar për arsye se e njëjta është në kundërshtim me provat tjera të administruara në shqyrtim gjyqësor, gjenden faktike të vërtetuar si dhe rrjedhën logjike të ngjarjes, i njëjti deklaratimet e tij i mbështetë në atë se çfarë ka dëgjuar nga e dëmtuara dhe assesi të ketë pasur njohuri lidhur me ngjarjen e pretenduar ngase në kohën për të cilën pretendohet në aktakuzë nuk ka qenë fare në vendin e ngjarjes.

Ajo çfarë e vë në dilemë besueshmërinë e dëshmisë së të dëmtuarës – dëshmitares G. M. dhe dëshmitarit B. M. qëndron fakti se edhe pse të njëjtit pretendojnë t'i kenë kërkuar vetëm njëherë dokumentet personale të saj dhe atë e dëmtuara drejtpërdrejtë nga i pandehuri me datë 07.08.2022 në pikën kufitare në M., ndërsa dëshmitari përmes telefonit nga babai i të pandehurit me datë 23.08.2022, për të vërtetuar faktin konkret nuk kanë ofruar asnjë provë konkrete se me të vërtetë nga i pandehuri kanë kërkuar kthimin e dokumenteve personale të saj, përveç kësaj, edhe përkundër sjelljeve të pandehurit se me datë 08.08.2022 bazuar në deklaratën e të dëmtuarës i njëjti e kishte tërhequr për flokësh dhe kishte tentuar që pa dëshirën e saj ta fus në veturën e tij për shkak se kjo e fundit i kishte thënë se nuk dëshiron të vazhdojë më me të, e dëmtuara tri ditë më vonë dhe atë me datë 11.08.2022, me dëshirën e saj kishte shkuar në dasmën e motrës së tij, po ashtu edhe përkundër faktit se me datë 18.08.2022 për

herë të fundit e dëmtuara së bashku me prindërit e saj kishin shkuar në familjen e të pandehurit, çështja e dokumenteve personale të saj nuk është diskutuar fare.

Gjykata ka analizuar me kujdes mbrojtjen e të pandehurit, i cili në të gjitha fazat e procedurës penale ka mohuar të ketë ndërmarrë ndonjë veprim konkret inkriminues në drejtim të veprës penale për të cilën është akuzuar, duke u mbrojtur me faktin se e dëmtuara e as ndonjëri nga anëtarët e familjes së saj asnjëherë nuk i kishin kërkuar atij dokumentet e saj personale, edhe pse me datë 11.08.2022 së bashku me ish bashkëshorten e tij G. M. kanë marrë pjesë në dasmën e motrës së tij, ndërsa me datë 18.08.2022 ka qenë kontakti i fundit në mes familjes së tij dhe asaj të dëmtuarës, për asnjë moment nuk ka qenë temë diskutimi kthimi i dokumenteve personale të të dëmtuarës, mbrojtjen e të cilit gjykata e çmoi si të bazuar ngase e njëjta është në përputhshmëri me gjendjen faktike të vërtetuar si dhe rrjedhën logjike të ngjarjes, ndërsa në shkresat e lëndës nuk ekziston ndonjë provë konkrete dhe e besueshme që do e vënin në dilemë mbrojtjen e tij.

Gjykata pas vlerësimit të rrethanave të rëndësishme, bazuar në faktet dhe provat e administruara në shqyrtimit gjyqësor, ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale prokuroria nuk ka arritur të ofrojë prova të mjaftueshme për të argumentuar faktin se i pandehuri në kohë, vend dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës ka kryer veprën penale “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës” nga neni 190 par. 2 të KPRK-së, andaj bazuar në nenin 7 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, i cili përcakton se gjykata, prokurori i shtetit dhe policia janë të detyruar që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, që me përkuqdesje të vërtetojë faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij, po ashtu bazuar në nenin 361 par 1 dhe 2 të KPPRK-së, gjykata aktgjykimin e bazon vetëm në faktet dhe provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor dhe detyrohet të vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të nxirret përfundim nëse fakti konkret është provuar.

Mbi bazën e arsyeve dhe rrethanave të sipërtheksuara, gjykata konstaton se në këtë çështje penale për shkak të dyshimit sa i përket ekzistimit të fakteve që e rëndojnë të pandehurin dhe pamundësisë së vërtetimit të tyre me bindje të plotë, duke u bazuar në parimin In Dubio Pro Reo parim ky i paraparë me nenin 3 par. 2 të KPPRK-së, konsiderohet se faktet e tilla nuk ekzistojnë andaj, konform nenit 363 par. 1 nën par. 1.3 të KPPRK-së, pasi që nuk është provuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, të njëjtin e liroi nga akuza. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marr në bazë të nenit 453 par.1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt juridiko civil është marrë në bazë të nenit 462 par. 3 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 363 par.1 nën par. 1.3 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal

P.nr. 1/23, datë. 15.05.2024

Numri i lëndës: 2023:004399
Datë: 15.05.2024
Numri i dokumentit: 05686937

Procesmbajtëse
Erblina Aliu

Gjyqtari i vetëm gjykues
Besnik Sheqiri

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimin të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.